EW9H188SC



SQ Tharëse me Rrotullim

Udhëzimet për përdorim

Electrolux

ME JU NË MENDJE

Faleminderit që bletë një produkt Electrolux. Ju keni zgjedhur një produkt i cili sjell me vete dekada të tëra me përvojë dhe risi nga profesionistë. Gjenial dhe elegant, ky produkt është projektuar duke ju pasur ju në mendje. Pra, sa herë që ta përdorni mund të ndjeheni të sigurt se çdo herë do të merrni prej tij rezultate të shkëlqyera.
Mirë se vini në Electrolux.
Vizitoni faqen tonë të internetit për:



Merrni këshilla përdorimi, broshura, informacion për ndreqjen e problemeve si dhe për shërbimin:

www.electrolux.com/webselfservice



Regjistroni produktin tuaj për shërbim më të mirë:

www.registerelectrolux.com



Blini aksesorë, pjesë konsumi, pjesë këmbimi origjinale për pajisjen tuaj:

www.electrolux.com/shop

KUJDESI DHE SHËRBIMI PËR KLIENTËT

Përdorni gjithmonë pjesë këmbimi origjinale.
Kur kontaktoni me Qendrën e Autorizuar të Shërbimit, sigurohuni që të dispononi të dhënat e mëposhtme: Modeli, PNC, Numri i serisë.
Informacioni mund të gjendet në pllakën e specifikimeve.
⚠ Paralajmërim / Të dhëna për sigurinë dhe kujdesin
ⓘ Të dhëna të përgjithshme dhe këshilla
Të dhëna për ambientin

Rezervohet mundësia e ndryshimeve.

PËRMBAJTJA

1. INFORMACIONI I SIGURISË.....6

1.1 Siguria e fëmijëve dhe personave me probleme.....6
1.2 Siguria e përgjithshme 7

2. UDHËZIMET PËR SIGURINË..... 9

2.1 Instalimi.....9
2.2 Lidhja elektrike..... 9
2.3 Përdorimi.....10
2.4 Ndriçimi i brendshëm..... 10
2.5 Kujdesi dhe pastrimi.....11
2.6 Kompresori.....11
2.7 Eliminimi i pajisjes..... 11

3. PËRSHKRIMI I PRODUKTIT..... 12

4. PANELI I KONTROLLIT.....13

4.1 Ekrani..... 14

5. WI-FI - KONFIGURIMI I LIDHJES..... 16

5.1 Instalimi dhe konfigurimi My Electrolux..... 16
5.2 Konfigurimi i lidhjes me valë të tharëses.....17
5.3 Ndezja në distancë..... 18
5.4 Përditësim over-the-air.....18

6. TABELA E PROGRAMEVE.....20

6.1 Woolmark Apparel Care - Blu..... 23

7. OPSIONET..... 24

7.1 Extra Anticrease (Antirrudhë) 24
7.2 Dryness Level (Tharja) 24
7.3 Time Dry (Tharje e programuar).....24
7.4 Time Dry (Tharje e programuar) në programin Wool (Të leshta).....24
7.5 Refresh (Rifreskim)..... 24
7.6 End Alert (Sinjalizuesi) 24
7.7 Reverse Plus (Rikthim plus) 25
7.8 Extra Silent (Ekstra i heshtur).....25

PËRMBAJTJA

7.9 Tabela e opsioneve.....26

8. CILËSIMET.....29

8.1 Funksioni i bllokimit për fëmijët..... 29
8.2 Rregullimi i lagështisë së mbetur..... 30
8.3 Treguesi i depozitës së ujit.....31

9. PËRPARA PËRDORIMIT TË PARË..... 32

10. PËRDORIMI I PËRDITSHËM.....33

10.1 Nisja e një programi pa vonimin e fillimit.....33
10.2 Nisja e programit me shtyrjen e fillimit të programit..... 33
10.3 Ndryshimi i një programi..... 33
10.4 Në përfundim të programit..... 34
10.5 Funksioni i gatishmërisë.....35

11. UDHËZIME DHE KËSHILLA.....36

11.1 Përgatitja e rrobave.....36

12. KUJDESI DHE PASTRIMI.....38

12.1 Pastrimi i filtrit.....38
12.2 Zbrazja e depozitës së ujit..... 39
12.3 Pastrimi i shkëmbyesit të nxehtësisë..... 40
12.4 Pastrimi i kazanit.....41
12.5 Pastrimi i panelit të kontrollit dhe karkasës.....41
12.6 Pastrimi i vrimave të qarkullimit të ajrit.....41

13. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE.....42

13.1 Nëse rezultatet e tharjes janë të pakënaqshme.....44

14. TË DHËNAT TEKNIKE.....46

14.1 Vlerat e konsumit..... 48

15. FLETA E INFORMACIONIT TË PRODUKTIT SIPAS RREGULLORES SË BE-SË 1369/2017.....50


Electrolux
electrolux.com/app
Available on the App Store
GET IT ON Google Play

1. ⚠ INFORMACIONI I SIGURISË

Përpara fillimit të instalimit dhe përdorimit të kësaj pajisjeje, lexoni me kujdes udhëzimet e dhëna. Prodhuesi nuk është përgjegjës për lëndimet apo dëmet si rezultat i instalimit apo përdorimit të papërshtatshëm. Gjithmonë mbajini udhëzimet në një vend të sigurt dhe ku mund të arrihen lehtë për t'iu referuar në të ardhmen.

- Lexoni udhëzimet e dhëna.

1.1 Siguria e fëmijëve dhe personave me probleme

⚠ PARALAJMËRIM!
Rrezik mbytjeje, plagosjeje ose gjymtimi të përhershëm.

- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e sipër dhe persona me aftësi të kufizuara fizike, ndijimesh ose mendore ose që nuk kanë eksperiencë dhe njohuri, nëse këta mbahen nën mbikëqyrje ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjes dhe i kuptojnë rreziqet e përdorimit.
- Fëmijët nga 3 deri në 8 vjeç dhe personat me aftësi të kufizuara shumë të theksuara dhe komplekse duhet të mbahen larg nga pajisja, përveçse kur mbahen nën monitorim të vazhdueshëm.
- Fëmijët nën 3 vjeç duhet të mbahen larg nga pajisja, përveçse kur mbikëqyren në mënyrë të vazhdueshme.
- Mos i lejoni fëmijët të luajnë me pajisjen.
- Mbajeni të gjithë paketimin larg nga fëmijët dhe hidheni atë siç kërkohet.
- Mbajini detergjentet larg fëmijëve.
- Mbajini fëmijët dhe kafshët shtëpiake larg pajisjes, gjatë kohës që dera e saj është e hapur.
- Nëse pajisja ka një mekanizëm për sigurinë e fëmijëve, ai duhet aktivizuar.

- Fëmijët nuk duhet të kryejnë pastrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes pa mbikëqyrje.

1.2 Siguria e përgjithshme

- Mos i ndryshoni specifikimet e kësaj pajisjeje.
- Nëse tharësja e rrobave montohet mbi një lavatriçe, përdorni setin e stivimit. Seti i stivimit, i disponueshëm nga shitësi juaj i autorizuar, mund të përdoret vetëm me pajisjen e specifikuar në udhëzime, të cilën e keni marrë me aksesorin. Lexojeni me kujdes përpara instalimit (referojuni broshurës së instalimit).
- Pajisja mund të instalohet më vete ose poshtë një banaku kuzhine me hapësirën e duhur (referojuni broshurës së instalimit).
- Mos e instaloni pajisjen pas një dere që kyçet, një dere rrëshqitëse apo një dere me menteshë në krahun e kundërt, e cila mund të pengojë hapjen e plotë të derës së pajisjes.
- Vrima e ajrimit në pjesën e poshtme nuk duhet të mbulohet nga tapeti, rrugica apo ndonjë mbulesë tjetër dyshemeje.
- KUJDES: Pajisja nuk duhet të furnizohet përmes një pajisjeje të jashtme ndezëse, si p.sh. kohëmatës, apo të lidhet me një qark që ndizet dhe fiket rregullisht nga një mjet.
- Futeni spinën në prizë vetëm në fund të procesit të montimit. Sigurohuni që spina elektrike të jetë e arritshme mbas instalimit.
- Për të shmangur rreziqet elektrike, nëse kablloja elektrike është e dëmtuar, ajo duhet ndërruar nga prodhuesi, qendra e autorizuar e shërbimit ose persona me kualifikim të ngjashëm.
- Mos tejkaloni ngarkesën maksimale prej 8 kg (referojuni kapitullit "Tabela e programeve").

INFORMACIONI I SIGURISË

- Mos e përdorni pajisjen nëse artikujt janë të ndotur me kimikate industriale.
- Fshini pushin ose mbetjet e paketimit që janë grumbulluar përreth pajisjes.
- Mos e përdorni pajisjen pa filtër. Pastrojeni filtrin e pushit përpara ose pas çdo përdorimi.
- Mos thani artikuj të palarë në tharëse.
- Artikujt e ndotur me substanca të tilla si vaj gatimi, aceton, alkool, benzinë, vajguri, heqës njollash, terpentinë, dyllë dhe heqës dylli duhet të lahen në ujë të nxehtë me një sasi shtesë detergjenti, përpara se të thahen në tharësen e rrobave.
- Artikujt e tillë si prej sfungjeri të gomuar (sfungjer lateks), skufjet e dushit, tekstilet rezistente ndaj ujit, artikuj me pjesë të gomuara si dhe rroba ose jastëkë me mbushje prej sfungjeri të gomuar, nuk duhet të thahet në tharësen e rrobave.
- Zbutësit e rrobave ose produkte të ngjashme duhet të përdoren vetëm sipas specifikimeve të udhëzimeve të prodhuesit të produktit.
- Hiqni të gjitha objektet nga artikujt që mund të bëhen burim zjarri, të tillë si çakmakët apo shkrepëset.
- PARALAJMËRIM: Mos e fikni asnjëherë tharësen përpara përfundimit të ciklit të tharjes, nëse të gjithë artikujt nuk nxirren shpejt dhe nuk hapen në mënyrë që nxehtësia të shpërndahet.
- Përpara se të kryeni shërbim mirëmbajtjeje, çaktivizoni pajisjen dhe hiqni spinën nga priza.

2. UDHËZIMET PËR SIGURINË

2.1 Instalimi

- Hiqni të gjithë paketimin.
- Mos instaloni ose mos përdorni një pajisje të dëmtuar.
- Ndiqni udhëzimet e instalimit të dhëna me pajisjen.
- Gjithmonë bëni kujdes kur e lëvizni pajisjen sepse është e rëndë. Përdorni gjithnjë doreza sigurie dhe këpucë të mbyllura.
- Mos e montoni ose mos e përdorni pajisjen në vende ku temperatura mund të jetë më e ulët se 5°C ose më të lartë se 35°C.
- Zona e dyshemesë ku do të instalohet pajisja duhet të jetë e sheshtë, e qëndrueshme, rezistente ndaj nxehtësisë dhe e pastër.
- Sigurohuni që ndërmjet pajisjes dhe dyshemesë të qarkullojë ajër.
- Gjithmonë mbajeni pajisjen vertikalisht kur e transportoni.
- Sipërfaqja e pasme e pajisjes duhet të vendoset kundrejt një muri.
- Pasi ta keni vendosur pajisjen në vendin e saj të përhershëm të punës, kontrolloni që të jetë saktësisht e niveluar me ndihmën e një niveluesi. Nëse jo, rregulloni këmbëzat siç duhet.

2.2 Lidhja elektrike

⚠ PARALAJMËRIM!

Rrezik zjarri dhe goditjeje elektrike.

- Pajisjen futeni në prizë vetëm në fund të instalimit. Sigurohuni që spina të jetë e arritshme pas montimit të pajisjes.
- Pajisja duhet tokëzuar.
- Sigurohuni që parametrat në pllakën e specifikimeve të përkojnë me vlerat elektrike të rrjetit elektrik.
- Përdorni gjithmonë një prizë me tokëzim të instaluar mirë.
- Mos përdorni përshtatës me shumë spina dhe kabllo zgjatuese.

- Mos e shkëputni pajisjen nga rrjeti duke e tërhequr nga kablloja elektrike. Gjithmonë tërhiqeni kabllon duke e kapur nga spina.
- Mos e prekni kabllon kryesore ose spinën e rrymës me duar të lagura.

2.3 Përdorimi

⚠ PARALAJMËRIM!

Rrezik plagosjeje, goditjeje elektrike, zjarri, djegieje ose dëmtimi të pajisjes.

- Kjo pajisje është vetëm për përdorim shtëpiak.
- Mos thani artikuj të dëmtuar (të grisur, të çarë) që përmbajnë material mbushës.
- Nëse rrobat janë larë me një heqës njollash, kryeni një cikël shtesë shpëlarjeje përpara se të filloni një cikël tharjeje.
- Thani vetëm rroba që janë të përshtatshme për tharjen në pajisje. Ndiqni udhëzimet e pastrimit në etiketën e artikujve.
- Mos pini ose mos përgatitni ushqime me ujë të kondensuar/ distiluar. Kjo mund të shkaktojë probleme shëndetësore te njerëzit dhe kafshët.
- Mos u ulni dhe mos peshoni mbi derën e hapur të pajisjes.
- Mos thani në pajisje rroba të lagura që pikojnë ujë.

2.4 Ndriçimi i brendshëm

⚠ PARALAJMËRIM!

Rrezik plagosjeje.

- Ka rrezatim të dukshëm LED, ndaj mos i ngulni sytë te drita.
- Drita LED i dedikohet ndriçimit të kazanit. Kjo llambë nuk mund të ripërdoret për qëllime të tjera ndriçimi.
- Për të zëvendësuar dritën e brendshme, lidhuni me qendrën e autorizuar të shërbimit.

2.5 Kujdesi dhe pastrimi

⚠ **PARALAJMËRIM!**
Rrezik plagosjeje ose dëmtim i pajisjes.

- Mos përdorni ujë me spërkatje dhe avull për të pastruar pajisjen.
- Pastrojeni pajisjen me një leckë të butë dhe të lagësht. Përdorni vetëm detergjente neutrale. Mos përdorni produkte gërryese, materiale të ashpra pastruese, tretës ose objekte metalike.
- Për të mos dëmtuar sistemin e ftohjes, tregoni kujdes kur pastroni pajisjen.

2.6 Kompresori

⚠ **PARALAJMËRIM!**
Rrezik dëmtimi i pajisjes.

- Kompresori dhe sistemi i tij në tharësen me rrotullim është i mbushur me një lëndë të veçantë, e cila nuk përmban hidrokarbure me fluor dhe klorur. Sistemi duhet të qëndrojë hermetik. Dëmtimi i sistemit mund të shkaktojë rrjedhje.

2.7 Eliminimi i pajisjes

⚠ **PARALAJMËRIM!**
Rrezik plagosjeje ose mbytjeje.

- Shkëputeni pajisjen nga rrjeti i furnizimit me energji dhe ai me ujë.
- Priteni kabllon e rrjetit elektrik pranë pajisjes dhe hidheni atë.
- Hiqni kapësen e derës për të parandaluar ngecjen e fëmijëve dhe të kafshëve shtëpiake brenda kazanit.
- Hidheni pajisjen në përputhje me kërkesat lokale për hedhjen e pajisjeve mbeturina elektrike dhe elektronike (WEEE).

3. PËRSHKRIMI I PRODUKTIT



1. Depozita e ujit
2. Paneli i kontrollit
3. Drita e brendshme
4. Dera e pajisjes
5. Filtro
6. Etiketa e specifikimeve
7. Vrimat e qarkullimit të ajrit
8. Kapaku i shkëmbyesit të nxehtësisë
9. Mbulesa e shkëmbyesit të nxehtësisë
10. Këmbëzat e rregullueshme

ⓘ

Për të ngarkuar me lehtësi rrobat ose për të lehtësuar instalimin, dera mund t'i ndryshohet krahu i hapjes. (shihni broshurën tjetër).

4. PANELI I KONTROLLIT



1 Çelësi i programeve dhe çelësi ● RESET
2 Butoni me prekje Extra Anticrease (Antirrudhë)
3 Butoni me prekje Dryness Level (Tharja)
4 Ekrani
5 Butoni me prekje Time Dry (Tharje e programuar)
6 Butoni me prekje Start/Pause (Nisja/Pauza)
7 Butoni me prekje Delay Start (Shtyrja)
8 Butoni me prekje Refresh (Rifreskim)
9 Butoni me prekje End Alert (Sinjalizuesi)
10 Butoni me prekje Reverse Plus (Rikthim plus)
11 Butoni me prekje Extra Silent (Ekstra i heshtur)
12 Butoni i ndezjes/fikjes

ⓘ

Shtypni blloqet e prekjes me gisht në zonën me simbolin ose emrin e opsionit. Mos mbani doreza veshur kur përdorni panelin e kontrollit. Sigurohuni që paneli i kontrollit të jetë gjithmonë i pastër dhe i thatë.

4.1 Ekrani



Simboli në ekran	Përshkrimi i simbolit
	opsioni i thatësisë së rrobave: tharje për hekurosje, për në dollap, ekstra
	opsioni i kohës së tharjes është i aktivizuar
	opsioni Vonesë në nisje është i aktivizuar
	treguesi: *Lidhja Wi-Fi*
	opsioni i nisjes në distancë është i aktivizuar
	treguesi: *kontrolloni shkëmbyesin e nxehtësisë*
	treguesi: *pastroni filtrin*
	treguesi: *zbrazni depozitën e ujit*
	bllokimi për fëmijët është i aktivizuar
– – –	përzgjedhje e gabuar

Simboli në ekran	Përshkrimi i simbolit
	treguesi: *faza e tharjes*
	treguesi: *faza e ftohjes*
	treguesi: *faza kundër rrudhave*
1:50	kohëzgjatja e programit
+30min., +60min., +90min., +2h	shtimi i fazës së parazgjedhur kundër rrudhave: +30 min, +60 min, +90 min, +2 orë)
:10 - 2:00	përzgjedhja e kohës së tharjes (10 min.-2 orë)
1h - 20h	përzgjedhja e shtyrjes së programit (1 orë - 20 orë)

5. WI-FI - KONFIGURIMI I LIDHJES

Ky kapitull përshkruan mënyrë se si të lidhni pajisjen smart me rrjetin Wi-Fi dhe si ta lidhni atë me pajisjet celulare.

Përmes këtij funksioni mund të merrni njoftime, mund të monitoroni dhe kontrolloni tharësen tuaj nga telefonat celularë.

Për të lidhur pajisjen për të përfituar nga gama e plotë e veçorive dhe e shërbimeve, ju nevojiten:

- Rrjet me valë në shtëpi me lidhje interneti të aktivizuar.
- Pajisje celulare e lidhur me rrjetin me valë.

Frekuenca	2.412 - 2.472 GHz për tregun evropian
Protokolli	IEEE 802.11b/g/n, radio me dy drejtime
Fuqia maksimale	<20 dBm

5.1 Instalimi dhe konfigurimi My Electrolux

Kur lidhni tharësen me aplikacionin, qëndroni pranë saj me pajisjen tuaj smart.

Sigurohuni që pajisja smart është e lidhur me rrjetin me valë.

1. Shkoni tek App Store në pajisjen tuaj smart.
2. Shkarkoni dhe instaloni aplikacionin My Electrolux .
3. Sigurohuni që të keni nisur një lidhje Wi-Fi në tharëse. Nëse jo, lexoni paragrafin e radhës *"Konfigurimi i lidhjes me valë të tharëses"*.
4. Nisni aplikacionin. Zgjidhni vendin dhe gjuhën dhe identifikohuni me emailin dhe fjalëkalimin tuaj. Nëse nuk keni një llogari, krijoni një të re duke ndjekur udhëzimet në My Electrolux
5. Ndiqni udhëzimet në aplikacion për regjistrimin dhe konfigurimin e pajisjes.

5.2 Konfigurimi i lidhjes me valë të tharëses

Sigurohuni që të keni shkarkuar dhe instaluar My Electrolux në pajisjen tuaj smart.

1. Shtypni butonin e ndezjes/fikjes për pak sekonda për të aktivizuar pajisjen.
2. Zgjidhni një program duke rrotulluar çelësin e programeve.
3. Shtypni dhe mbani shtypur butonat me prekje **Time Dry (Tharje e programuar)** dhe **Delay Start (Shtyrja)** për **3** sekonda.

Teksti On shfaqet për rreth 5 sekonda dhe ikona fillon të pulsojë dhe moduli me valë fillon të ndizet. Mund të duhen rreth 45 sekonda përpara se të jetë gati. Kur është gati moduli me valë, teksti AP (**Access Point**) aktivizohet për t'ju informuar se pika e aksesit do të hapet për rreth 3 minuta.

4. Konfiguroni aplikacionin My Electrolux në pajisjen tuaj smart.
5. Nëse është konfiguruar lidhshmëria, simboli i AP (**Access Point**) fiket dhe ikona do të ndalojë së pulsuari dhe qëndron i ndezur prë të konfirmuar se konfigurimi ishte i suksesshëm.

ⓘ

Sa herë që ndizni pajisjen, ekrani kërkon 45 sekonda për t'u lidhur me rrjetin automatikisht. Kur treguesi ndalon pulsimin, lidhja është gati.

Për të çaktivizuar lidhjen me valë, shtypni dhe mbani shtypur butonat me prekje **Time Dry (Tharje e programuar)** dhe **Delay Start (Shtyrja)** për **3** sekoknda derisa sinjali i parë akustik: OFF shfaqet në ekran.

ⓘ

Nëse e fikni dhe e ndizni sërish pajisjen, lidhja me valë fiket automatikisht.

Për të hequr kredencialet e lidhjes me valë, shtypni dhe mbani shtypur butonat me prekje **Time Dry (Tharje e programuar)**

dhe Delay Start (Shtyrja) për **10** sekoknda derisa sinjali i dytë akustik: – – – shfaqet në ekran.

5.3 Ndezja në distancë

Kur është instaluar aplikacioni dhe është kryer lidhja me valë, mund të ndizni dhe ndaloni një program tharjeje në distancë duke aktivizuar nisjen në distancë.

ⓘ

Kontrolli në distancë aktivizohet automatikisht kur shtypni butonin **Start/Pause (Nisja/Pauza)** për të nisur programin, por është e mundur që të niset një program tharjeje.

Aktivizimi i ndezjes në distancë

1. Shtypni butonin **Delay Start (Shtyrja)** () dhe treguesi APP shfaqet në ekran.
2. Shtypni butonin **Start/Pause (Nisja/Pauza)** për të aktivizuar Ndezjen në distancë.

Treguesit shfaqen në ekran. Tani është e mundur të nisni programin në distancë.

Çaktivizimi i ndezjes në distancë

Shtypni butonin me prekje **Delay Start (Shtyrja)** () dhe konfirmoni duke shtypur butonin **Start/Pause (Nisja/Pauza)**.

Ikona fiket dhe nisja në distancë çaktivizohet.

ⓘ

Nëse hapet dera, çaktivizohet **Ndezja në distancë**.

ⓘ

Pozicioni i rivendosjes ● çaktivizon Nisjen në distancë.

5.4 Përditësim over-the-air

Aplikacioni mund të propozojë një përditësim për shkarkimin e veçorive të reja.

Përditësimi pranohet vetëm përmes aplikacionit.

Nëse një program është në punë, aplikacioni njofton se përditësimi do të nisë në përfundim të programit.

Gjatë përditësimit, pajisja shfaq UPd në ekran.

Pajisja do të jetë e përdorshme sërish në përfundim të përditësimit, pa asnjë njoftim rreth përditësimit të suksesshëm.

Nëse ndodh një gabim, pajisja shfaq Err në ekran: thjesht shtypni çdo buton ose ktheni çelësin për t'iu kthyer përdorimit normal.

6. TABELA E PROGRAMEVE

Programi	Ngarkesa [1]	Veçoritë / Lloji i tekstilit[2]	
[3] Cotton (Të pambukta) **Eco**	**8 kg**	Cikli që përdoret për të tharë të pambukta me nivelin e tharjes "për në dollap" me kursim maksimal energjie.	/
Cotton (Të pambukta)	**8 kg**	Cikli i përcaktuar për të tharë të gjitha llojet e pambukut gati për gati për dollap (tharje për dollap).	/
Synthetics (Sintetike)	**3,5 kg**	Tekstile sintetike dhe të përziera.	/
Mixed (I shpejtë për rroba të përziera) **XL**	**6 kg**	Përzierje rrobash prej pambuku, përzierje pambuk-sintetike dhe tekstile sintetike.	/
Delicates (Delikate)	**4 kg**	Tekstile delikate të tilla si viskoza, najloni, akriliku dhe përzierjet e tyre.	/
Sport (Sportive)	**2 kg**	Rroba sporti, tekstile të holla dhe të lehta, rrobat me mikrofibra, poliestër.	/

Programi	Ngarkesa [1)]	Veçoritë / Lloji i tekstilit[2)]	
Down Jacket (Xhup me pupla)	**2 kg**	Xhupa me pupla, si edhe mbushje sintetike dhe tekstile me mbulesë teknike. Thajeni me zinxhirë të mbyllur.	/
Bedlinen (Shtrat) **XL**	**4,5 kg**	Deri në tre sete shtrojash për krevat, një prej të cilave mund të jetë dopjo.	/
Outdoor	**2 kg**	Rroba që vishen jashtë, rroba pune, sportive, xhaketa të papërshkueshme nga uji, xhupa me shtresë të heqshme me push ose me izolim të brendshëm. Të përshtatshme për tharje në tharëse rrobash.	/
Denim (Xhinse)	**4 kg**	Veshje sportive, të tilla si xhinse, bluza etj, me trashësi të ndryshme materiali (p.sh. në pjesën e qafës, manshetave dhe tegelave).	/

TABELA E PROGRAMEVE

Programi	Ngarkesa [1)]	Veçoritë / Lloji i tekstilit[2)]	
Silk (Mëndafsh)	**1 kg**	Tharje delikate e rrobave të mëndafshta që mund të lahen me dorë.	/
Wool (Të leshta)	**1 kg**	Tekstile leshi. Tharje delikate e rrobave të leshta që mund të lahen me dorë. Nxirrini menjëherë artikujt kur programi të ketë përfunduar.	

1) Pesha maksimale u referohet artikujve të tharë.

2) Për kuptimin e shenjës së tekstilit, shikoni kapitullin *UDHËZIME DHE KËSHILLA: Përgatitja e rrobave.*

3) Programi Cotton (Të pambukta) Tharje për dollap ECO është “Programi standard i pambukut” sipas Rregullores së Komisionit (BE) Nr. 392/2012. Është i përshtatshëm për tharjen e rrobave të lagura normale prej pambuku dhe ky është programi më efikas për sa i përket konsumit të energjisë për tharjen e rrobave të lagura prej pambuku.

6.1 Woolmark Apparel Care - Blu

	Cikli i tharjes për të leshtat në këtë lavatriçe është miratuar nga "The Woolmark Company" për tharjen e rrobave të leshta që mbajnë etiketën "për larje me dorë" nëse rrobat thahen sipas udhëzimeve të prodhuesit të kësaj makinerie. Ndiqni etiketën e kujdesit për rrobat për udhëzime të tjera rreth tyre. M1741 Simboli Woolmark është markë certifikimi në shumë vende.

7. OPSIONET

7.1 Extra Anticrease (Antirrudhë)

E zgjat me 30, 60, 90 minuta ose 2 orë fazën kundër rrudhave në përfundim të ciklit të tharjes. Ky funksion redukton rrudhat. Rrobat mund të nxirren nga pajisja gjatë fazës kundër rrudhave.

7.2 Dryness Level (Tharja)

Ky funksion ndihmon në përmirësimin e tharjes së rrobave. Ka 3 opsione:

- Extra Dry (Tharje ekstra)
- Tharje për dollap
- Tharje për hekurosje

7.3 Time Dry (Tharje e programuar)

Ju mund të vendosni kohëzgjatjen e programit, për një minimum 10 minutash deri maksimumi në 2 orë. Kohëzgjatja e kërkuar lidhet me sasinë e rrobave në pajisje.

ⓘ

Rekomandojmë që të vendosni një kohëzgjatje të shkurtër për sasi të vogla rrobash ose vetëm për një artikull.

7.4 Time Dry (Tharje e programuar) në programin Wool (Të leshta)

Opsioni i përshtatshëm për programin Wool (Të leshta) për të rregulluar nivelin përfundimtar të tharjes.

7.5 Refresh (Rifreskim)

Për rifreskimin e rrobave që kanë ndenjur brenda në dollap. Ngarkesa maksimale nuk mund të tejkalojë 1 kg.

7.6 End Alert (Sinjalizuesi)

Zilja do të tingëllojë:

- në përfundim të ciklit
- në fillim dhe përfundim të fazës kundër rrudhave

- në ndërprerjen e ciklit

Funksioni i sinjalizuesit është vendosur nga fabrika që të qëndrojë ndezur. Këtë funksion mund ta përdorni për të aktivizuar ose çaktivizuar sinjalin.

ⓘ

Ju mund të aktivizoni opsionin End Alert (Sinjalizuesi) me të gjitha programet.

7.7 ↻ Reverse Plus (Rikthim plus)

Rrisni shpeshtësinë e rrotullimit të kazanit për të reduktuar përdredhjen dhe ngecjen e rrobave. Për të rritur uniformitetin e rezultatit të tharjes dhe për të ndihmuar në reduktimin e rrudhave. Rekomandohet për artikuj të mëdhenj ose të gjatë (p.sh. çarçafë, pantallona, fustane të gjata)"

7.8 🔉 Extra Silent (Ekstra i heshtur)

Pajisja funksionon me zhurmë të ulët pa efekte në cilësinë e tharjes. Pajisja funksionon me ngadalë me kohë më të gjatë cikli.

7.9 Tabela e opsioneve

Programet[1)]	☀ Dryness Level (Tharja)			Extra Anticrease (Antirrudhë)	Extra Silent (Ekstra i heshtur)	Reverse Plus (Rikthim plus)	Refresh (Rifreskim)	Time Dry (Tharje e programuar)
	☀	☀	☀					
Cotton (Të pambukta) **Eco**		■		■				
Cotton (Të pambukta)	■	■	■	■	■	■	■	■
Synthetics (Sintetike)	■	■	■	■	■	■	■	■
Mixed (I shpejtë për rroba të përziera) **XL**	■	■		■		■		■
Delicates (Delikate)		■		■				

Programet[1)]	Dryness Level (Tharja)			Extra Anti crease (Antirrudhë)	Extra Silent (Ekstra i heshtur)	Reverse Plus (Rikthim plus)	Refresh (Rifreskim)	Time Dry (Tharje programuar)
	☀	☀	☀					
Sport (Sportive)		■		■				
Down Jacket (Xhup me pupla)	■	■						
Bedlinen (Shtrat) **XL**	■	■	■	■		■		
Outdoor		■						
Denim (Xhinse)	■	■		■		■		
Silk (Mëndafsh)		■		■				

Programet[1)]	☀ Dryness Level (Tharja)			Extra Anticrease (Antirrudhë)	Extra Silent (Ekstra i heshtur)	Reverse Plus (Rikthim plus)	Refresh (Rifreskim)	Time Dry (Tharje e programuar)
	☀	☀	☀					
Wool (Të leshta)								■ 2)

1) Së bashku me programin mund të vendosni 1 ose më shumë opsione. Për t'i aktivizuar ose çaktivizuar ato, shtypni fushën përkatëse me prekje.

2) Shikoni kapitullin OPSIONET: Time Drying (Tharje e programuar) në programin Wool (Të leshta)

8. CILËSIMET



A. Butoni me prekje Time Dry (Tharje e programuar)
B. Butoni me prekje Start/Pause (Nisja/Pauza)
C. Butoni me prekje Delay Start (Shtyrja)
D. Butoni me prekje Refresh (Rifreskim)
E. Butoni me prekje End Alert (Sinjalizuesi)
F. Butoni me prekje Reverse Plus (Rikthim plus)
G. Butoni me prekje Extra Silent (Ekstra i heshtur)
H. Butoni me prekje Extra Anticrease (Antirrudhë)
I. Butoni me prekje Dryness Level (Tharja)

8.1 Funksioni i bllokimit për fëmijët

Ky opsion nuk lejon që fëmijët të luajnë me pajisjen gjatë kohës që ajo është në punë. Butonat me prekje bllokohen.

Zhbllokohet vetëm butoni ndezje/fikje.

Aktivizimi i opsionit të bllokimit për fëmijët:

1. Shtypni butonin e ndezjes/fikjes për të aktivizuar pajisjen.
2. Mbani shtypur butonin e prekjes (**D**) për pak sekonda.

Treguesi i bllokimit për fëmijët ndizet.

ⓘ

Opsioni i bllokimit për fëmijët mund të çaktivizohet ndërkohë që është në punë një program. Prekni dhe mbani prekur të njëjtat butona prekjeje derisa treguesi i bllokimit për fëmijët të fiket. Funksioni i bllokimit për fëmijët nuk është i disponueshëm për 8 sekonda pas ndezjes së pajisjes.

8.2 Rregullimi i lagështisë së mbetur

ⓘ

Sa herë që hyni në regjimin "Rregullimi i nivelit të mbetur të lagështirës në rroba" shkalla e vendosur më parë për lagështinë e mbetur do të ndryshojë në vlerën e radhës (p.sh. e vendosur më parë - 2 - do të kalojë në - 1 -).

Për të ndryshuar shkallën e parazgjedhur të lagështisë së mbetur:

1. Shtypni butonin e ndezjes/fikjes për të aktivizuar pajisjen.
2. Përdorni përzgjedhësin e programit për të vendosur një program.
3. Prisni afërsisht 8 sekonda.
4. Shtypni dhe mbani shtypur njëkohësisht butonat (**G**) dhe (**F**).

Një nga këta tregues ndizet:

- - 0 - tharja maksimale
- - 1 - më shumë rroba të thata
- - 2 - rroba me thatësi standarde

5. Shtypni dhe mbani përsëri shtypur butonat (**G**) dhe (**F**) derisa të ndizet treguesi i nivelit të duhur.

ⓘ

Nëse ekrani kthehet në regjimin normal (koha e programit të zgjedhur nga hapi 2 do të shfaqet), ndërsa vendoset shkalla e lagështisë së mbetur, shtypni dhe mbani shtypur butonat (**G**) dhe (**F**) sërish për të hyrë në regjimin e larjes "Rregullimi i nivelit të mbetur të lagështirës në rroba" (shkalla e vendosur më parë për lagështinë e mbetur do të ndryshojë në vlerën e radhës).

6. Për të pranuar nivelin e zgjedhur të lagështirës, prisni 5s dhe ekrani kthehet në gjendjen normale.

Dryness Level (Tharja)	Simboli në ekran

- 0 - tharja maksimale	
- 1 - më shumë rroba të thata	
- 2 - rroba me thatësi standarde	

8.3 Treguesi i depozitës së ujit

Si parazgjedhje, treguesi i depozitës së ujit është aktiv. Ai ndizet kur programi ka përfunduar ose kur nevojitet zbrazja e depozitës së ujit.

ⓘ

Nëse është instaluar kompleti i zbrazjes (aksesor shtesë), pajisja e zbraz automatikisht ujin nga depozita e ujit. Në këtë rast, ne rekomandojmë që ta çaktivizoni treguesin e depozitës së ujit.

Çaktivizimi i treguesit të depozitës së ujit:

1. Shtypni butonin e ndezjes/fikjes për të aktivizuar pajisjen.
2. Prisni afërsisht 8 sekonda.
3. Prekni dhe mbani prekur njëkohësisht butonat me prekje (**H**) dhe (**I**).

Ekrani tregon një nga këto 2 konfigurime:

- Ekrani shfaq "Off" (Joaktiv). Pas 5 sekondash ekrani kthehet në modalitetin normal.
- Ekrani shfaq "On" (Aktiv). Pas 5 sekondash ekrani kthehet në modalitetin normal.

9. PËRPARA PËRDORIMIT TË PARË

ⓘ

Paketimi i pasmë i kazanit hiqet automatikisht kur tharësja aktivizohet për herë të parë. Mund të dëgjoni pak zhurmë.

Përpara se të përdorni pajisjen për herë të parë:

- Pastroni me një leckë të njomë kazanin e tharëses së rrobave.
- Nisni një program 1 orësh me rroba të njoma.

ⓘ

Në fillim të ciklit të tharjes (3 - 5 minuta) niveli i zhurmës mund të jetë paksa më i lartë. Kjo ndodh për shkak të ndezjes së kompresorit. Kjo është normale për pajisjet me kompresor të tilla si frigoriferët dhe ngrirësit.

10. PËRDORIMI I PËRDITSHËM

10.1 Nisja e një programi pa vonimin e fillimit

1. Përgatitni rrobat dhe ngarkoni pajisjen.

> ⚠ **KUJDES!**
> Sigurohuni që kur të mbyllni derën, rrobat të mos ngecin mes derës së pajisjes dhe guarnicionit prej gome.

2. Shtypni butonin e ndezjes/fikjes për të aktivizuar pajisjen.
3. Vendosni programin dhe opsionet e duhura sipas llojit të ngarkesës.

Ekrani tregon kohëzgjatjen e programit.

> ⓘ
> Koha reale e tharjes do të varet nga lloji i ngarkesës (sasia dhe përbërja), temperatura e dhomës dhe lagështira e rrobave tuaja pas fazës së centrifugimit.

4. Shtypni butonin me prekje Start/Pause (Nisja/Pauza).

Programi fillon.

10.2 Nisja e programit me shtyrjen e fillimit të programit

1. Vendosni programin dhe opsionet e duhura sipas llojit të ngarkesës.
2. Shtypni butonin e shtyrjes së programit vazhdimisht derisa ekrani të shfaqë kohën e vonesës që dëshironi të vendosni.

> ⓘ
> Ju mund të shtyni fillimin e një programi nga minimumi 1 orë deri maksimumi në 20 orë.

3. Prekni butonin me prekje Start/Pause (Nisja/Pauza).

Ekrani tregon numërimin mbrapsht të shtyrjes së programit.

Programi fillon pas përfundimit të numërimit mbrapsht.

10.3 Ndryshimi i një programi

1. Shtypni butonin e ndezjes/fikjes për të çaktivizuar pajisjen

2. Shtypni butonin e ndezjes/fikjes për të aktivizuar pajisjen.
3. Caktoni programin.

Ose:

1. Rrotullojeni çelësin përzgjedhës në pozicionin ● "Reset" (Rivendos).
2. Pritni për 1 sekondë. Ekrani shfaq – – –.
3. Caktoni programin.

10.4 Në përfundim të programit

Kur programi ka përfunduar:

- Bie një sinjal akustik i ndërprerë.
- Ekrani shfaq 0 : 0 0
- Treguesi ☞ ndizet.
- Treguesit ⊕ Filter (Filtri) dhe Tank (Depozita) mund të ndizen.
- Treguesi Start/Pause (Nisja/Pauza) është ndezur.

Pajisja vazhdon të punojë me fazën kundër rrudhave për rreth 30 minuta të tjera ose më shumë nëse është vendosur opsioni Extra Anticrease (Antirrudhë) (shikoni kapitullin *Opsioni - Extra Anticrease (Antirrudhë)*).

Faza kundër rrudhave redukton rrudhat.

Mund t'i hiqni rrobat përpara përfundimit të fazës kundër rrudhave. Për rezultate më të mira, rekomandojmë t'i hiqni rrobat kur faza pothuajse të ketë përfunduar.

Kur faza kundër rrudhave ka përfunduar:

- Ekrani vazhdon të shfaqë 0 : 0 0
- Treguesi ☞ fiket.
- Treguesit ⊕ Filter (Filtri) dhe Tank (Depozita) qëndrojnë të ndezur.
- Start/Pause (Nisja/Pauza) treguesi fiket.

1. Shtypni butonin e ndezjes/fikjes për të çaktivizuar pajisjen.
2. Hapni derën e pajisjes.

3. Nxirrni rrobat nga pajisja.
4. Mbyllni derën e pajisjes.

ⓘ

Gjithmonë pastroni filtrin dhe zbrazni depozitën e ujit kur të përfundojë programi.

10.5 Funksioni i gatishmërisë

Për të ulur konsumin e energjisë, ky funksion çaktivizon automatikisht pajisjen:

- Pas rreth 5 minutash nëse nuk nisni programin.
- Pas 5 minutash nga përfundimi i programit.

ⓘ

Koha reduktohet në 30 sekonda nëse çelësi përzgjedhës tregon pozicionin ● "Reset" (Rivendos).

11. UDHËZIME DHE KËSHILLA

11.1 Përgatitja e rrobave

- Mbyllni zinxhirët.
- Mbyllni mbërthyeset e këllëfëve të jorganëve.
- Mos i thani të palidhura kollaret ose rripat (p.sh. rripat e përparëseve). Lidhini ato përpara se të nisni një program.
- Nxirrini të gjithë artikujt nga xhepat.
- Kthejini nga ana tjetër artikujt me shtresën e brendshme prej pambuku. Shtresa e pambukut duhet të jetë jashtë.
- Vendosni gjithmonë programin e përshtatshëm për llojin e rrobave.
- Mos i vendosni ngjyrat e errëta së bashku me ngjyrat e çelura.
- Përdorni një programin të përshtatshëm për fanella pambuku dhe trikotazhe për të reduktuar hyrjen në ujë.
- Mos tejkaloni ngarkesën maksimale të treguar në kapitullin e programeve ose që tregohet në ekran.
- Thani vetëm rroba që janë të përshtatshme për tharjen në tharëse. Referojuni etiketës së pëlhurës që kanë artikujt.
- Mos thani së bashku artikuj shumë të mëdhenj dhe artikuj shumë të vegjël. Artikujt e vegjël mund të ngecin brenda artikujve të mëdhenj dhe mbeten të lagur.

Etiketa e pëlhurës	Përshkrimi
	Rrobat janë të përshtatshme për tharjen.
	Rrobat janë të përshtatshme për tharjen në tharëse me temperatura të larta.
	Rrobat janë të përshtatshme për tharjen në tharëse vetëm me temperatura të ulëta.

Etiketa e pëlhurës	Përshkrimi
	Rrobat nuk janë të përshtatshme për tharjen në tharëse.

12. KUJDESI DHE PASTRIMI

12.1 Pastrimi i filtrit

⚠ KUJDES!

Shmangni përdorimin e ujit për të pastruar filtrin. Në vend të tij hidheni pushin në koshin e mbeturinave (shmangni përhapjen e fibrave plastike në ambientin ujor).

ⓘ

Për të arritur performancën më të mirë në tharje, pastrojeni filtrin rregullisht, filtrat e bllokuar sjellin cikle më të gjata dhe rrisin konsumin e energjisë.
Përdorni dorën për të pastruar filtrin, dhe nëse është e nevojshme, një fshesë me korrent.

1.



2.



3.



4.



5. **1)**



6.



1) Nëse është e nevojshme hiqni pushin nga filtri dhe guarnicioni. Për këtë mund të përdorni një fshesë me korrent.

12.2 Zbrazja e depozitës së ujit

1.



2.



3.



4.



ⓘ

Ju mund të përdorni ujin nga depozita e ujit si alternative për ujë të distiluar (p.sh. për hekurosje me avull). Përpara se të përdorni ujin, hiqni papastërtitë me filtër.

12.3 Pastrimi i shkëmbyesit të nxehtësisë

1.



2.



3.



4.



5.



6.



7.



8.



9.



⚠ **KUJDES!**
Mos prekni sipërfaqet metalike me duar të zhveshura. Rrezik plagosjeje. Vishni dorashka mbrojtëse. Pastroni me kujdes që të shmangni dëmtimin e sipërfaqes metalike.

12.4 Pastrimi i kazanit

⚠ **PARALAJMËRIM!**
Shkëputeni pajisjen nga korrenti përpara se ta pastroni.

Përdorni një sapun larës neutral standard për të pastruar sipërfaqen e brendshme të kazanit dhe filtrat e kazanit. Thajini sipërfaqet e pastruara me një leckë të butë.

⚠ **KUJDES!**
Mos përdorni materiale gërryese apo lesh teli për të pastruar kazanin.

12.5 Pastrimi i panelit të kontrollit dhe karkasës

Përdorni një sapun larës neutral standard për të pastruar panelin e kontrollit dhe karakasën.

Pastrojeni me një pëlhurë të njomë. Thajini sipërfaqet e pastruara me një leckë të butë.

⚠ **KUJDES!**
Mos përdorni agjentë për pastrimin e mobilieve ose agjentë pastrues të cilët mund të shkaktojnë gërryerje.

12.6 Pastrimi i vrimave të qarkullimit të ajrit

Përdorni një fshesë me korrent për të hequr pushin nga vrimat e qarkullimit të ajrit.

13. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

Problemi	Zgjidhja e mundshme
Nuk mund ta aktivizoni pajisjen.	Sigurohuni që spina të jetë futur në prizë.
	Kontrolloni siguresën në kutinë e siguresave (instalimin shtëpiak).
Programi nuk fillon.	Shtypni Start/Pause (Nisja/ Pauza).
	Sigurohuni që dera e pajisjes të jetë e mbyllur.
Dera e pajisjes nuk mbyllet.	Sigurohuni që instalimi i filtrit të jetë bërë si duhet.
	Sigurohuni që rrobat të mos ngecin mes derës së pajisjes dhe guarnicionit prej gome.
Pajisja ndalon gjatë punës.	Sigurohuni që depozita e ujit të jetë bosh. Shtypni Start/Pause (Nisja/Pauza) për të nisur sërish programin.
	Ngarkesa është tepër e vogël, rritni ngarkesën ose përdorni programin Koha.
Koha e ciklit është tepër e gjatë ose ka rezultate të pakënaqshme në tharje.[1)]	Sigurohuni që pesha e rrobave të jetë e përshtatshme për kohëzgjatjen e programit.

Problemi	Zgjidhja e mundshme
	Sigurohuni që filtri të jetë i pastër.
	Rrobat janë tepër të lagura. Centrifugojini rrobat sërish në lavatriçe.
	Sigurohuni që temperatura e dhomës të jetë më e lartë se +5°C dhe më e ulët se +35°C. Temperatura optimale e dhomës është 19°C deri në 24°C.
	Caktoni programin Koha ose Extra Dry (Tharje ekstra).[2)]
Aplikacioni nuk mund të lidhet me tharësen.	Kontrolloni nëse pajisja smart është e lidhur me rrjetin me valë. Kontrolloni rrjetin dhe ruterin e shtëpisë. Ndizeni sërish ruterin. Kontaktoni me ofruesin e shërbimit të internetit me valë nëse ka probleme me rrjetin me valë.
	Tharësja, pajisja smart, ose të dyja, duhet të konfigurohen sërish.

Problemi	Zgjidhja e mundshme
Aplikacioni nuk mund të lidhet shpesh me tharësen.	Përpiquni ta lëvizni ruterin e shtëpisë sa më pranë tharëses që të jetë e mundur ose konsideroni blerjen e një pajisjeje përforcuese për rrezen e rrjetit me valë.
	Fikni mikrovalën. Shmangni përdorimin e mikrovalës dhe telekomandës së furrës njëkohësisht. Mikrovala ndërpret sinjalin Wi-Fi.
Ekrani shfaq – – –.	Nëse dëshironi të vendosni një program të ri, çaktivizoni dhe aktivizoni pajisjen.
	Sigurohuni që opsionet të jenë të përshtatshme për programin.
Ekrani shfaq kodin e gabimit (p.sh. **E51**).	Çaktivizoni dhe aktivizoni pajisjen. Nisni një program të ri. Nëse problemi ndodh përsëri, lidhuni me qendrën e shërbimit.

1) Pas maksimumi 5 orësh, programi përfundon automatikisht.

2) Mund të ndodhë që disa zona të mbeten të lagështa kur thani artikuj të mëdhenj (p.sh. çarçafë krevati).

13.1 Nëse rezultatet e tharjes janë të pakënaqshme

- Programi i vendosur ishte i pasaktë.
- Filtri është i bllokuar.
- Shkëmbyesi i nxehtësisë është bllokuar.

- Në pajisje ka shumë rroba.
- Kazani është i papastër.
- Cilësim i pasaktë i sensorit të përçueshmërisë (shihni kapitullin "*Cilësimet - Rregullimi i nivelit të mbetur të lagështirës në rroba*" për cilësim më të mirë).
- Vrimat e qarkullimit të ajrit janë të bllokuara.
- Temperatura e dhomës është tepër e ulët ose tepër e lartë (temperatura optimale e dhomës është 19°C deri 24°C)

14. TË DHËNAT TEKNIKE

Gjerësia x Lartësia x Thellësia	850 x 596 x 638 mm (maksimale 662 mm)
Thellësia maksimale me derën e pajisjes të hapur	1107 mm
Gjerësia maksimale me derën e pajisjes të hapur	958 mm
Lartësia e rregullueshme	850 mm (+ 15 mm - rregullimi i këmbëve)
Vëllimi i kazanit	118 t
Vëllimi maksimal i ngarkesës	**8** kg
Tensioni	230 V
Frekuenca	50 Hz
Niveli i fuqisë së zhurmës	63 dB
Fuqia totale	700 W
Klasi i efikasitetit të energjisë	**A+++**
Konsumi i energjisë në programin standard të pambukut me ngarkesë të plotë. [1)]	**1,47** kWh
Konsumi i energjisë në programin standard të pambukut me ngarkesë të pjesshme. [2)]	**0,83** kWh

Konsumi vjetor i energjisë[3)]	176,50 kWh
Majtas - thithja e energjisë në modalitetin e mbetur ndezur [4)]	0,05 W
Thithja e energjisë në modalitetin fikur [4)]	0,05 W
Konsumi i energjisë në gatishmëri në rrjet[4)]	2,0 W
Koha deri në gatishmëri në rrjet[4)]	15 min.
Lloji i përdorimit	Shtëpiak
Temperatura e lejuar e ambientit	+ 5°C deri në + 35°C
Niveli i mbrojtjes ndaj hyrjes së grimcave të ngurta dhe lagështisë sigurohet nga kapaku mbrojtës, përveç rastit kur pajisja me tension të ulët nuk ka mbrojtje kundër lagështisë	**IPX4**
Ky produkt përmban gaz të fluorinuara të efektit serrë, të mbyllur hermetikisht	
Emërtimi i gazit	R134a
Pesha	0,30 kg

Potenciali i ngrohjes globale (GWP)	1430

1) Referuar EN 61121. 8 kg pambuk, i centrifuguar me 1000 rpm.

2) Referuar EN 61121. 4 kg pambuk, i centrifuguar me 1000 rpm.

3) Konsumi i energjisë në vit në kWh, bazuar në 160 cikle tharjeje të programit standard për të pambuktat me ngarkesë të plotë dhe të pjesshme dhe konsumi i modaliteteve me fuqi të ulët. Konsumi aktual i energjisë për cikël do të varet nga mënyra se si përdoret pajisja (RREGULLORJA (BE) Nr. 392/2012).

4) Duke iu referuar EN 61121.

Informacionet e dhëna në tabelën më lart janë në përputhje me direktivën implementuese 2009/125/EC të rregullores 392/2012 të Komisionit të BE-së.

14.1 Vlerat e konsumit

Programi	Centrifugimi në / lagështia e mbetur	Koha e tharjes[1)]	Konsumi i energjisë[2)]
Cotton (Të pambukta) **Eco** 8 kg			
Tharje për dollap	1400 rpm / 50%	134 min.	1,30 kWh
	1000 rpm / 60%	152 min.	1,47 kWh
Cotton (Të pambukta) 8 kg			
Tharje për hekurosje	1400 rpm / 50%	103 min.	0,93 kWh

Programi	Centrifugimi në / lagështia e mbetur	Koha e tharjes[1)]	Konsumi i energjisë[2)]
	1000 rpm / 60%	125 min.	1,09 kWh
Cotton (Të pambukta) **Eco** 4 kg			
Tharje për dollap	1400 rpm / 50%	90 min.	0,76 kWh
	1000 rpm / 60%	97 min.	0,83 kWh
Synthetics (Sintetike) 3,5 kg			
Tharje për dollap	1200 rpm / 40%	57 min.	0,47 kWh
	800 rpm / 50%	66 min.	0,58 kWh

1) Për ngarkesa të pjesshme, koha e ciklit është më e shkurtër dhe pajisja përdor më pak energji.

2) Temperatura e papërshtatshme e ambientit dhe/ose rrobat e pacentrifuguara mirë mund të zgjasin kohën e ciklit dhe rrisin konsumin e energjisë.

15. FLETA E INFORMACIONIT TË PRODUKTIT SIPAS RREGULLORES SË BE-SË 1369/2017

Fleta e informacionit të produktit	
Marka tregtare	Electrolux
Modeli	EW9H188SC PNC916098642
Kapaciteti nominal në kg	8
Tharëse me ventilim ose me kondensim	Aparat kondensimi
Klasi i efikasitetit të energjisë	A+++
Konsumi i energjisë në vit në kWh, bazuar në 160 cikle tharjeje të programit standard për të pambuktat me ngarkesë të plotë dhe të pjesshme dhe konsumi i regjimeve me fuqi të ulët. Konsumi aktual i energjisë për cikël do të varet nga mënyra e përdorimit të pajisjes.	176,50
Tharëse automatike ose tharëse joautomatike	Automatike
Konsumi i energjisë i programit standard të pambukut me ngarkesë të plotë në kWh	1,47
Konsumi i energjisë i programit standard të pambukut me ngarkesë të pjesshme në kWh	0,83
Konsumi i energjisë në regjimin e fikur në W	0,05
Konsumi i energjisë në regjimin e lënë ndezur në W	0,05

Kohëzgjatja e regjimit të lënë ndezur në minuta	10
“Programi standard i pambukut” i përdorur me ngarkesë të plotë dhe të pjesshme është programi standard i tharjes me të cilin lidhet informacioni në etiketë dhe në fletë, ky program është i përshtatshëm për tharjen e rrobave të pambukut me lagie normale dhe është programi më efikas në lidhje me konsumin e energjisë për pambukun.	
Koha e ponderuar e programit të “programit standard të pambukut me ngarkesë të plotë dhe të pjesshme” në minuta	121
Koha e programit të “programit standard të pambukut 60°C me ngarkesë të plotë” në minuta	152
Koha e programit të “programit standard të pambukut 60°C me ngarkesë të pjesshme” në minuta	97
Klasi i efikasitetit të tharjes me kondensim në një shkallë nga G (më pak efikase) në A (më efikase)	A
Efikasiteti mesatar i kondensimit të programit standard të pambukut me ngarkesë të plotë si përqindje	91
Efikasiteti mesatar i kondensimit të programit standard të pambukut me ngarkesë të pjesshme si përqindje	91

FLETA E INFORMACIONIT TË PRODUKTIT SIPAS RREGULLORES SË BE-SË 1369/2017

Koha e ponderuar e tharjes me kondensim për “programin standard të pambukut me ngarkesë të plotë dhe të pjesshme”	91
Niveli i fuqisë së zhurmës dB	63
Pajisje inkaso Po/Jo	Jo

Informacionet e dhëna në tabelën më lart janë në përputhje me direktivën implementuese 2009/125/EC të rregullores 392/2012 të Komisionit të BE-së.

16. ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AMBIENTIN

Ricikloni materialet me simbolin ♺. Vendoseni ambalazhin te kontejnerët e riciklimit nëse ka. Ndihmoni në mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve dhe në riciklimin e mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike. Mos hidhni pajisjet e shënuara me simbolin e mbeturinave shtëpiake. Ktheni produktin në pikën lokale të riciklimit ose kontaktoni me zyrën komunale.

www.electrolux.com/shop

136963990-A-322019

CE



electrolux.com/app

Available on the App Store

GET IT ON Google Play

The software included in this product contains copyrighted software that is licensed under the BSD, GPL-2.0, LGPL-2.0, LGPL-2.1, zLib, MIT, ISC, Apache 2.0 and others. It is possible to display the complete copy of the licenses in the Electrolux App that can be downloaded from the corresponding App store from the License menu section. It is possible to download the source code of the open source software used in the product by searching for Wi-Fi Module Software version in NIUX subfolder at the following website: **http://electrolux.opensoftwarerepository.com**.